



Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë

**DEPARTAMENTI PËR TË DREJTAT E NJERIUT, DECENTRALIZIM DHE
KOMUNITETE**

Seksioni për Monitorimin e Sistemit Juridik

Raporti Mujor –Korrik 2007

Dështimi i përfaqësuesve të autorizuar që gjatë procedurës penale t'u asistojnë viktimave të rrezikuara të veprave penale, paraqet shkelje të ligjit vendës

OSBE është e shqetësuar se në disa raste të monitoruara, përfaqësuesit e autorizuar nuk u kanë dhënë ndihmë viktimave të rrezikuara të veprave penale ashtu siç e parashikon ligji.

Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale i Kosovës (KPPPK)¹ parashikon dhënien e ndihmës nga ana e përfaqësuesit të autorizuar², që nga fillimi i procedurës penale për viktimat që i takojnë grupeve të ndjeshme³, siç janë, fëmijët, viktimat e dhunës seksuale a gjinore, viktimat e trafikimit me njerëz dhe viktimat nga marrëdhënia familjare me të pandehurin⁴.

Sipas ligjit të Kosovës, përfaqësuesi i autorizuar e ka për detyrë t'i mbrojë të drejtat e palës së dëmtuar, ta mbrojë integritetin e tij/saj gjatë marrjes në pyetje, ta paraqesë dhe mbrojë kërkesën pronësore juridike⁵. Gjithashtu, kur pala e dëmtuar nuk e angazhon përfaqësuesin e autorizuar autoritetet kompetente për zhvillimin e procedurës në fazën paraprake, duhet ta emërojnë sipas detyrës zyrtare përfaqësuesin e autorizuar në shpenzime publike⁶.

Përkundër këtyre detyrimeve të qarta ligjore, OSBE ka monitoruar raste kur organi kompetent nuk e ka caktuar përfaqësuesin e autorizuar për të dëmtuarit që i takojnë këtyre kategorive të viktimave.

Në një lëndë penale para Gjykatës së (), lidhur me veprën penale të ()⁷, më 2007, pala e dëmtuar e ka dhënë deklaratën para prokurorit pa praninë e përfaqësuesit të autorizuar ose pa praninë e mbrojtësit të viktimave. Prokurori nuk e ka caktuar përfaqësuesin sipas detyrës zyrtare, ashtu si e parashikon ligji⁸.

Në lëndën penale para Gjykatës (,) lidhur me veprën penale të (),⁹ as pala e dëmtuar dhe e mitur, e as përfaqësuesi i saj ligjor nuk e ka angazhuar përfaqësuesin e autorizuar për t'i ndihmuar palës gjatë gjykimit. Në seancën e hapjes së gjykimit më (), kryetari i kolegjit nuk e ka caktuar përfaqësuesin e autorizuar sipas detyrës zyrtare. Sipas

¹ Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2003/26 mbi Kodin e Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës (KPPPK), 6 korrik 2003.

² Sipas KPPPK-së, mbrojtësi i viktimave nga Njësia për mbrojtjen e viktimave i ndihmon të dëmtuarit edhe si përfaqësues i autorizuar, neni 81(4), KPPPK. Kjo njësi së fundi është zëvendësuar nga Divizioni për ndihmë dhe mbrojtje viktimave.

³ Neni 78, KPPPK përcakton parimin e përgjithshëm sipas të cilit "Organi kompetent që zbaton procedurën penale gjatë gjithë rrjedhës së procedurës penale duhet të ketë parasysh nevojat e arsyeshme të dëmtuarve, veçanërisht të fëmijëve, personave të moshuar, personave me çrregullime ose me paaftësi mendore dhe viktimave të dhunës seksuale a gjinore." Kjo dispozitë është frymëzuar nga Deklarata mbi parimet e përgjithshme të drejtësisë për viktimat e krimit, keqpërdorimit të pushtetit, e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara... sipas të cilës "përgjigja e proceseve gjyqësore dhe administrative ndaj nevojave të viktimave duhet të lehtësohet (...) duke dhënë asistencë të duhur për viktimat gjatë gjithë procesit ligjor". Rezoluta e KB, 40/34, e 29 nëntorit 1985, para 6.

⁴Neni 82(1), KPPPK

⁵ Neni 81(3), KPPPK.

⁶ Neni 82(2), KPPPK.

⁷ Neni 139, Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës (KPPK), (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2003/25, mbi Kodin e Përkohshëm Penal të Kosovës, 6 korrik 2003).

⁸ Neni 82(2), KPPPK.

⁹ Neni 195(1) KPPK.

përfaqësuesit ligjor të palës së dëmtuar, ajo nuk kishte nevojë për ndihmë ngase pala e dëmtuar “e tregonte të vërtetën”(sic).

Në një rast të hetuar nga (), lidhur me veprën penale të ()¹⁰ të kryer në marrëdhënie familjare, më datën (), prokurori e kishte marrë në pyetje gruan e të pandehurit pa e caktuar më parë sipas detyrës zyrtare përfaqësuesin e autorizuar.

Dështimi i organeve kompetente për caktimin e përfaqësuesit të autorizuar për t'i ndihmuar viktimat, nga shembujt e mësipërm, jo vetëm që paraqet shkelje të ligjit në fuqi,¹¹ por edhe nuk adreson në mënyrë adekuate nevojën për mbrojtjen e viktimave që u takojnë grupeve të ndjeshme.

Në kuptim të asaj që u tha më lart, OSBE rekomandon:

- Në rastet e viktimave që u takojnë grupeve të rrezikuara, prokurorët, gjyqtarët dhe organet tjera relevante duhet t'i caktojnë përfaqësuesit e autorizuar për t'ju ndihmuar atyre ashtu siç e parashikon ligji.
- Mbrojtësit e viktimave nga Njësia për mbrojtje dhe ndihmë viktimave, duhet në mënyrë pro-aktive t'i ndihmojnë dhe mbrojnë viktimat gjatë procedurës penale.
- Instituti Gjyqësor i Kosovës, të organizojë trajnime të përbashkëta për të gjithë aktorët relevantë të procedurës penale (përfshirë gjyqtarët, prokurorët, mbrojtësit e viktimave, avokatët dhe psikologët/pedagogët) mbi të drejtat ligjore të viktimave të ndjeshme.

Veprimet e UNMIK-ut dhe autoriteteve komunale paraqesin ndërhyrje të pavend ndaj pavarësisë së gjyqësorit

OSBE është e shqetësuar lidhur me veprimet e zyrtarit të UNMIK-ut dhe letrën e dërguar nga UNMIK-u dhe autoritetet komunale tek gjykatat e () lidhur me interpretimin e kontratave, se paraqet ndërhyrje në pavarësinë e gjyqësorit.

E drejta e pavarësisë së gjyqësorit është pjesë themelore e të drejtës për gjykim të drejtë, të njohur me instrumentet dhe traktatet universale dhe rajonale për të drejtat e njeriut,¹² e të cilat janë drejtpërsëdrejti të zbatueshme në Kosovë.¹³ Gjatë interpretimit të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (ECHR), Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) ka theksuar

¹⁰ Neni 153, KPPK.

¹¹ Tri kategoritë e krimeve të përmendura në këta shembuj përfshihen nga neni 82, i KPPK-së (shih neni 82(1), nr. 2 dhe nr. 3, të KPPK-së).

¹² Për traktatet dhe instrumentet ndërkombëtare, shih, p.sh., neni 10, të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (DUDNJ), Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme të KB-ra 217A (III), 10 dhjetor 1948; neni 14(1), Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (PNDCP), Rezoluta e KB-ra 2200A (XXI), 16 dhjetor 1966. Në nivelin rajonal, shih neni 6(1), të Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut, miratuar në Romë më 4 nëntor 1950.

¹³ Rregullorja e UNMIK-ut nr. 1999/24 mbi ligjin në fuqi në Kosovë, 12 dhjetor 1999 (e ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/59, 27 tetor 2000), neni 1.3; Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9 mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë, 15 maj 2001, neni 3.2.

se pavarësia e gjyqësorit kërkon që secili gjyqtarë të jetë i lirë nga udhëzimet nga jashtë.¹⁴ Për shembull, sa herë që pushteti ekzekutiv ofron interpretim detyrues të legjislacionit, gjyqësori në ato raste nuk është i pavarur.¹⁵

Gjithashtu, parimi i ndarjes së pushtetit, është element themelor i konceptit të sundimi të ligjit.¹⁶ Në harmoni me këtë parim, Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë, parashikon që gjykatat dhe gjyqtarët të jenë “të pavarur dhe të paanshëm.”¹⁷

Përkundër këtyre kërkesave ligjore, OSBE ndanë shqetësimin lidhur me rastin e fundit të ndërhyrjes ose ndikimit të pavend ndaj gjykatave të Kosovës dhe nga ana e aktorëve jo-gjyqësor.¹⁸

Në rastin e fundit, pasi që Gjykata () e ka vërtetuar një kontratë mbi shitblerjen e një shtëpie të lidhur midis një romi dhe një shqiptari të Kosovës, e që gjendet në (), më 7 maj 2007 një zyrtar i UNMIK-ut i ka vizituar kryetarët e Gjykatës së () dhe asaj Komunale të (). Sipas informatave në dispozicion të OSBE-së qëllimi i këtyre takimeve ishte të diskutohet ligjshmëria e shitblerjeve të shtëpive nga (), të ndërtuara nga donatorët mbi bazën e marrëveshjes trepalëshe midis donatorit, përfituesit dhe komunës.¹⁹

Edhe pse fillimisht kryetarët e gjykatave e kishin përkrahur pikëpamjen se marrëveshja trepalëshe nuk i ndalon këto shitblerje (megjithëse nuk ka pasur ndonjë proces të iniciuar nga palët e marrëveshjes trepalëshe ku gjykata do t'i interpretonte kushtet e kontratës), kryetarët e gjykatave ishin pajtuar ta pezullonin vërtetimin e këtyre shitblerjeve. Kryetarët i kanë sugjeruar UNMIK-ut që ta dorëzojë një dokument të shkruar me të cilin theksohet se ndalohen këto shitblerje përveç kur palët i plotësojnë disa kushte specifike.

¹⁴ Shih GJEDNJ, *Campbell dhe Fell kundër Mbretërisë së Bashkuar* Nr. 7819/77; 7878/77, aktgjykimi i 28 qershorit 1984, para. 77 - 82; GJEDNJ, *Sovtransavto Holding kundër Ukrainës* nr. 48553/99, aktgjykimi i datës 25 korrik 2002, para. 80.

¹⁵ Shih GJEDNJ, *Beaumont kundër Francës*, nr. 15287/89, aktgjykimi i 24 nëntorit 1994, para. 38.

¹⁶ Secila degë e pushtetit (ekzekutivi, legjislativi dhe gjyqësori) ka fuqi të ndara dhe të pavarura, si dhe përgjegjësi të ndara. Për definicionin e “sundimit të ligjit” shih raportin e Sekretarit të Përgjithshëm, *Sundimi i ligjit dhe drejtësia nën tranzicion në shoqëritë e konfliktit dhe pas konfliktit*, UN-Doc. S/2004/616, 23 gusht 2004, para. 6. Parimi i përgjithshëm i gjyqësorit të pavarur është edhe më tej përqafuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara dhe kërkohet nga legjislacionin vendës, shih *Parimet themelor të pavarësisë së gjyqësorit*, miratuar nga Kongresi i Shtatë i Kombeve të Bashkuara mbi parandalimin e krimit dhe trajtimin e kryerësve, të mbajtur në Milano prej 26 gushtit deri me 6 shtator 1985 dhe miratuar me rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme 40/32 të 29 nëntor 1985 dhe 40/146 të 13 dhjetorit 1985.

¹⁷ Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9 mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë, 15 maj 2001, nenet 9.4.3 dhe 9.4.6.

¹⁸ OSBE më herët ka raportuar shqetësimet lidhur me ndërhyrjen e autoriteteve të UNMIK-ut në gjyqësor dhe për mungesën e mbikëqyrjes gjyqësore ndaj veprimeve të pushtetit ekzekutiv. Shih raportet si në vijim të Departamentit të OSBE-së për të drejtat të njeriut, komunitete dhe decentralizim; Seksioni për monitorim të sistemit juridik: raportet mujore, shtator 2006 (ndërhyrja e UNMIK-ut në ekzekutimin e urdhëresave për bastisje); Shqyrtimi i sistemit të drejtësisë penale (shtator 2001-shkurt 2002) -- Temat: Pavarësia e gjyqësorit, burgimi dhe çështjet e shëndetit mental; faqe 25-44, http://www.osce.org/documents/mik/2002/04/965_en.pdf.

¹⁹ UNMIK-u në mënyrë të kuptueshme ka shfaqur brengën se shitjet e shtëpive nga () do të mund ta rrezikonte të gjithë projektin e kthimit në (). Shih ueb-faqen DRC (): <http://www.drc-kosovo.org/>.

Pas vizitës së datën () nga ana e zyrtarit të UNMIK-ut, kryetari i gjykatës () gojarisht ka urdhëruar nëpunësin përgjegjës të gjykatës për vërtetimin e transaksioneve pronësore juridike, që të mos i vërtetojë kontratat të cilat kanë të bëjnë me shitblerjen e pronave që gjenden në .²⁰ Më 14 maj 2007, UNMIK-u dhe zyrtarët komunalë i kanë dërguar letër kryetarëve të gjykatave me sqarimin se njëra nga dispozitat e marrëveshjes trepalëshe duhet të interpretohet ashtu se e ndalon shitblerjen e shtëpive pa pëlqimin e dhënë nga palët nënshkruese të marrëveshjes për shkak të qëllimit të përfituesit që të kthehet dhe të banojë në atë shtëpi. Në letër thuhet:

“Neni 7 i marrëveshjes thekson “me nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje, përfituesi ripohon qëllimin e tij/saj për t’u kthyer dhe/ose të vazhdojë të jetojë në shtëpi.” Për këtë arsye, marrëveshja e ndalon shitjen dhe tjetërsimin e cilësdo shtëpi pa njohurinë dhe dhënien e pëlqimit nga palët tjera nënshkruese, dhe para skadimit të periudhës së përcaktuar në marrëveshje.”

OSBE është e shqetësuar se veprimi i zyrtarëve të UNMIK-ut dhe atyre komunalë – përkundër qëllimit për nxitjen së kthimit të komuniteteve pakicë – paraqet ndërhyrje në pavarësinë e gjyqësorit. Sipas ligjit në fuqi në Kosovë, vërtetimi i kontratave pronësore është funksion i cili i është ndarë gjykatave²¹. Nga kjo arsye, gjykatat e Kosovës – dhe jo zyrtarët e UNMIK-ut apo komunës – e kanë përgjegjësinë dhe fuqinë e interpretimit të kushteve të kontratës ose ligjshmërisë së kontratës së propozuar për vërtetim.

UNMIK-u dhe zyrtarët komunalë kanë ndikuar në vendimin e gjykatave që ta ndërpresin vërtetimin e transaksioneve pronësore. Vizita e zyrtarit të UNMIK-ut dhe ajo letër kanë shkaktuar ndikim të papërshtatshëm në gjykatat. Ky ndikim është edhe më i fuqishëm nga fakti se UNMIK-u është i autorizuar ta bëjë emërimin dhe shkarkimin e gjyqtarëve nga funksioni.²²

Rrjedhimisht, veprimet e UNMIK-ut dhe zyrtarëve komunalë ishin të gabuara dhe kanë shkelur parimin e ndarjes së pushtetit dhe pavarësisë së gjyqësorit.

Në kuptim të asaj që u tha më lart, OSBE rekomandon që:

- Gjyqtarët t’i përmbahen në mënyrë të rreptë ligjit, rezistojnë presionit – çoftë gojor ose përmes formave tjera të komunikimit – nga aktorët jashtë gjyqësor në punën e tyre, dhe t’i raportojnë rastet e ndërhyrjes tek Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

²⁰ Më 11 maj 2007, krye-shefi ekzekutiv i () ka deklaruar në një intervistë televizive se nuk ishte e mundur shitja e shtëpive nga (). Në të njëjtën kohë, një () i Kosovës i cili e kishte shitur shtëpinë e vet, kishte deklaruar se e kishte blerë përsëri shtëpinë e vet pasi që ishte bindur në mënyrë të suksesshme nga krye-shefi ekzekutiv që të qëndrojë.

²¹ Shih nenin 10.1 Ligji mbi qarkullimin e pasurisë së paluajtshme, Gazeta Zyrtare e Republikës Socialiste të Serbisë, nr. 15/74, 13 prill 1974, dhe nr. 14/77, 9 prill 1977: “[kontrata në bazë të së cilës bartet e drejta e shfrytëzimit të pasurisë së paluajtshme, ose e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, duhet të hartohet me shkrim dhe nënshkrimet duhet të vërtetohen në gjykatë.” Shih gjithashtu nenin 1(1) dhe 192 të Ligjit mbi procedurën jashtë-kontestimore (LPJK), Gazeta Zyrtare e KSA të Kosovës nr. 42, 24 tetor 1986.

²² Neni 1.5 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2005/52 mbi themelimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, 20 dhjetor 2005.